



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 6, Date 26/01/2001

**PER
VENDOSJEN E GJOBAVE NGA BASHKIA TIRANE**

Mbështetur në nenin 113.2 të Kushtetutës, në ligjin 8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin rrugor, të jetë si më poshtë:

a. Dëmtim, çarje, ndotje rruge:	L./m2	10.000 deri 100.000
b. Bllokim rruge	L./ml	10.000 deri 50.000
c. Dëmtim, çarje, ndotje trotuari	L./m2	10.000 deri 100.000
d. Bllokim trotuari	L./ml	10.000 deri 50.000
e. Dëmtim bordure	L./ml	10.000 deri 50.000
f. Dëmtim, bllokim pusete, kunete	L./copë	20.000 deri 50.000
g. Vjedhje zgarë	L./copë	10.000 deri 30.000

2. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin elektrik rrugor, të jetë si më poshtë:

a. Lidhjet e pa-miratuara në kandelabrat apo rrjetin ajror	L./copë	10.000 deri 30.000
b. Dëmtim i shtyllave:	L./copë	20.000 deri 50.000
c. Dëmtim i ndriçuesve:	L./copë	10.000 deri 20.000
d. Përdorimi i shtyllave si suport për montimin e Reklamave, kapjen e kablove, etj:	L./copë	10.000 deri 20.000

- e. Dëmtimi i traseve kabllorë e linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje si edhe shkujja e shtyllave L./copë 20.000 deri 50.000
- f. Ndërhyrjet në kuadrot e komandimit: L./copë 10.000 deri 50.000
3. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ujësjellësit, të jetë si më poshtë:
- a. Lidhjet e pamiratuara në tubacion L./copë 10.000 deri 30.000
- b. Dëmtim i pusetave L./copë 10.000 deri 30.000
- c. Dëmtimi I tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje L./copë 20.000 deri 50.000
4. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në hapsirat e gjelbra dhe publike, të jetë si më poshtë:
- a. Dëmtim hapsire të gjelbër: L./m² 10.000 deri 50.000
- b. Dëmtim, prerje pemësh: V1 e dëmit L./copë 10.000 deri 50.000
- c. Zënie hapsire të gjelbër pa leje: L./m² 5.000 deri 30.000
- d. Vendosje posterash pa leje: L./copë 100 deri 200
- e. Vendosje tabelash, pankartash, Banderolash pa leje: L./copë 1.000 deri 10.000
5. Niveli i gjobave për kryerjen e aktiviteteve tregtare pa licencë, të jetë si më poshtë:
- a. Mospajisje me licencë transporti: L. 20.000 deri 30.000
- b. Mospajisje me leje veprimtarie për Servis për riparimin e mjeteve të transportit Shërbim-Rimorkim mjeteve të difektuara, Lavazhi, parking, gomisteri L. 10.000 deri 100.000
- c. Mospajisje me leje për funksionimin si stacion shitjeje Karburanti me pakicë: L. 50.000 deri 100.000
- d. Mospajisje me leje për tregtimin e Gazetave, Revistave, Librarive L. 20.000 deri 50.000
- e. Mospajisje me leje për shërbim tregtar ambulator me autodyqan L. 10.000 deri 30.000
- f. Mospajisje me leje për “Ushtrim Aktiviteti 24-orësh” L. 50.000 deri 100.000
- g. Mospajisje me leje për vendosje Reklame L. 30.000 deri 60.000
6. Niveli i gjobave për mos-shlyerjen e taksave vendore, të jetë si më poshtë:

- | | | |
|----|--------------------------------------------------------|------------------------|
| a. | Mospagim i taksave vendore në afatin e duhur | L.5.000 deri 10.000 |
| b. | Mospagim taksash | L. 10.000 deri 50.000 |
| c. | Fshehje e detyrimit fiskal | L. 20.000 deri 100.000 |
| d. | Falsifikim i detyrimit fiskal | L. 20.000 deri 80.000 |
| e. | Mosdhënie informacioni | L. 10.000deri 100.000 |
| f. | Mosnjoftimi për ndryshime në të dhënat e Taksapaguesve | L. 20.000 deri 50.000 |
7. Kur dëmtimet apo ndërhyrjet e parashkruara në Pikat 1, 2, 3 dhe 4 kryhen:
- Nga Subjektet e Shërbimit; niveli i gjobave dy-fishohet
 - Nga Subjektet e Ndërtimit; niveli i gjobave tre-fishohet
8. Vendosja e gjobave për pikat 1, 2, 3 dhe 4 të bëhet nga Drejtoria e Inspektoriatit të Mjedisit Urban dhe Policia Bashkiake në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndërmarrjeve denoncuese sipas specifikës, ndërsa për pikat 5 dhe 6 të bëhet nga Sektori i Tatim Taksave pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik. Vjelja e tyre të bëhet pranë Ndërmarrjes së Tregjeve dhe Taksave
9. Të ardhurat e realizuara nga gjobat e vjelura, të ndahen si vijon:
- 40% në zërin investime
 - 20% në zërin shpenzime
 - 40% në zërin shpërblime
10. Ngarkohet Bashkiak e Tiranës të nxjerrë udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA